



KOMUNA E PRISHTINËS

Kryetari i Komunës

01.nr.31 - 228280 , më 06.09.2016

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, dt. 15.06.2008), të nenit 12 dhe 13 të Vendimit për kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve, 01. Nr. 031 - 112404 të dt. 12.05.2014 dhe të nenit 52 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr.110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës më 05.09.2016, merr këtë:

### V E N D I M

- I. MIRATOHET kërkesa OJQ-së SHHFPP- Shoqata për hulumtimin e fatit të personave të pagjetur nga Prishtina për subvencionim të qirasë për zyrën e kontraktuar.
- II. Shuma e mjeteve financiare të lejuara për subvencionimin e SHHFPP nga pika I e këtij Vendimi do të jetë 3.000 €.
- III. Mjetet e ndara do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të qirasë për periudhën një vjeçare, duke llogaritur 250 € në muaj.
- IV. Pagesa e cekur në pikën II të këtij Vendimi do të realizohet e ndarë në dy këste nga 1.500 €. Kësti i parë do të paguhet në shtator të vitit 2016, ndërsa kësti i dytë në janar të vitit 2017.
- V. Pagesat do të bëhen në xhirlogarinë e Haki Kasumit, përfaqësues i shoqatës në KKAFFZHK - Këshilli koordinues i asociacioneve të familjarëve të zhdukurve të Kosovës.
- VI. Shpenzimet e shumës së lejuar për subvencion duhet të arsyetohen përmes raportit të shpenzimeve.

VII. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave e Komunës së Prishtinës.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së tij.

I Dorëzohet:

- Kërkuesit,
- Drejtorisë së Financave,
- Qendrës për shërbime me qytetarë, dhe
- Në dosje.



KRYETARI KOMUNËS  
Sipënd Ahmeti